




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER RIDVANA G. RUÇI  
ADRESA KAJO KARAFILI  
TEL: 683030361



# VERTETIM NENSHKRIMI

(AKT THEMELIMI)

Nr. repertori: 7186

Tirane më 14/12/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



V2022053240396743309

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER RIDVANA G. RUÇI



VERTETIM STATUT dhe AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"Euro-Beton Group" SH.P.K

Sot më datë 17/12/2022 une noterja Ridvana Ruci, me Zyre ne rrugen "Kajo Karafili", deklaroj se para meje u paraqit personalisht personi i meposhtem i cili me kerkoj hartimin dhe nenshkrimin e ketij Statuti dhe Akti Themelimi te nenshkruarit

Yllka Sula, atësia Zenel, amësia Ferdane, shtetas Shqiptar, lindur në Tirane dhe banues në Tiranë, me adresë Bajram Curri; Nd. 0; H. 0; Ap. 0; Njësia Administrative Nr. 3; Njesia Bashkiake Nr. 4; 0000; Tiranë, lindur më 08/08/1974, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjofitim ID nr. 034573969 dhe nr. personal H45808140E, .

Subjekti i mësipërm, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqit dhe nënshkroi përpara meje Noteres, "Akti Themelimi dhe Statutin, bashkëlidhur.

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e saj.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER  
RIDVANA G. RUÇI





**AKT THEMELIMI**  
**&**  
**STATUT I SHOQËRISË TREGTARE TË SË DREJTËS SHQIPTARE**  
**Euro-Beton Group**

Sot, me date 14/12/2022 ne cilesine e ortakes se shoqerise **Euro-Beton Group** shpk ne personat e meposhtem biem dakort per hartimin dhe nenshkrimin e ketij Statuti dhe Akti Themelimi një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K)

-Yllka Sula, atësia Zenel, amësia Ferdane, shtetas Shqiptar, lindur në Tirane dhe banues në Tiranë, me adresë Bajram Curri; Nd. 0; H. 0; Ap. 0; Njësia Administrative Nr. 3; Njesia Bashkiake Nr. 4; 0000; Tiranë, lindur më 08/08/1974, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 034573969 dhe nr. personal H45808140E

Ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", te ndryshuar, dhe me legjislacionin e zbatueshem ne Republiken e Shqiperise, kemi miratuar kete Statut si vijon:

**KAPITULLI I**  
**THEMELIMI – EMRI – FORMA – SELIA - OBJEKTI – KOHEZGJATJA**

**Neni 1**  
**Themelimi, Emri dhe Forma**

Emri dhe emertimi tregtar i Shoqerise eshte **Euro-Beton Group shpk**.  
Shoqeria **Euro-Beton Group** eshte nje person juridik privat, e themeluar ne baze te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" (me pas referuar si "Ligji Tregtar") ne formen e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar (Sh.P.K.).  
Shoqeria fiton personalitetin juridik me regjistrimin e saj ne regjistrin tregtar qe mbahet nga Qendra Kombetare te Biznesit (me pas referuar si "QKB") ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara nga ligji.  
Me fitimin e personalitetit juridik, Shoqeria behet pergjegjese kundrejt paleve te treta, per detyrimet dhe demet qe shkakton gjate veprimtarise se saj.  
Ortaket e Shoqerise do te jene pergjegjes kundrejt paleve te treta deri ne shumen e kontributit te derdhur ne kapitalin themeltar te Shoqerise.

**Neni 2**  
**Selia**

Shoqeria do ta kete seline e saj ne adresen e meposhtme: Rruga "Themistokli Germenji", Shkalla 1, kati 5, Apartamenti 18, Njesia Administrative 2, Tirane.  
Me vendim te Administratorit, Shoqeria mund te çele dege dhe/ose zyra perfaqesimi kudo brenda Republikës së Shqipërisë.

**Neni 3**  
**Objekti**

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të përfshijë sa vijon:





V2022053240396743309

Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë thellësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës:

Veprimtari në fushën e ndërtimit të përgjithshëm. Veprimtari në fushën e Prodhimit dhe Tregimit të betonit. Veprimtari në fushën e projektimit. Tregim i materialeve të ndërtimit, import-export. Ndërtim dhe shfrytëzim i linjave të fabrikave për prodhimin e materialeve të ndërtimit. Ndërtime të përgjithshme industriale dhe civile, ndërtimi i rrugëve, autostradave, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro dhe pista aeroportuale si dhe rikonstruksioni i rrugëve të kategorive të ndryshme. Shtimin e objekteve të veprimtarisë së shoqërisë duke përfshirë në veprimtarinë e saj: Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje e fasada, punime në tokësore, ura e vepra arti, diga dhe tunele hidroteknike, ujësjellës, vajsjellës, gazsjellës, vepra kullimi e vaditje, ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë, punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime, ndërtim i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike, ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatoreve, linja e TN të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë, punime të inxhinierisë së mjedisit, impiante hidro-sanitare, kuzhina lavanderi, mirëmbajtja e tyre, impiante ngritëse dhe transportues, ashensorë, shkallë levizëse, transportues, impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut, sinjalistike rrugore jo ndriçuese, impiante teknologjike termike dhe të kondicionimit, impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni, impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, tv, ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimi i tij, ndërtimi i impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane, punime topogjeodezike, shpime gjeologjike inxhinierike, puse e shpime për ujë. Rehabilitim dhe rikonstruksion i monumenteve arkitekturore të kategorive të ndryshme. Grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim dhe asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme. Marrje dhe dhenie me qira e automjeteve dhe mjete të tjera. Prodhim dhe shitje energjie nga burime të tjera alternative, burime të rinovueshme, ndërtim i hidrocentraleve, centraleve fotovoltaike, energji solare, etj, në Republikën e Shqipërisë dhe jashtë saj. Aktivitet në fushën imobilare, dhenia dhe marrja me qira e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme. Hapjen e restoranteve, bareve, resorteve turistike. Investimin në fushën e hotelierisë turistike, dhe me konkretesht ndërtimin, menaxhimin, administrimin e qendrave turistike. Në përgjithësi të gjitha aktivitetet industriale, tregtare, financiare, civile, të luajtshme ose të paluajtshme, që mund të lidhen direkt ose indirekt me objektin e shoqërisë ose me objekt të ngjashëm ose të përafërt.

Sidoqoftë, asgjë nuk do të interpretohet këtu si kufizim i mundësisë së shoqërisë për të hyrë në tregje apo aktivitete dhe operacione të tjera tregtare që janë të lidhura me apo në funksion të objektit të mësipërm.

Objekti i aktivitetit të Shoqërisë mund të ndryshohet dhe/ose zgjerohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe këtë Statut.

Sidoqoftë, asgjë nuk do të interpretohet këtu si kufizim i mundësisë së shoqërisë për të hyrë në tregje apo aktivitete dhe operacione të tjera tregtare që janë të lidhura me apo në funksion të objektit të mësipërm.

Objekti i aktivitetit të Shoqërisë mund të ndryshohet dhe/ose zgjerohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe këtë Statut.

#### **Neni 4 Kohegjatja**

Kohegjatja e Shoqërisë është e pakufizuar. Shoqëria mund të prishet në çdo kohë me një vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

## **KAPITULLI II KAPITALI – KUOTAT**



**Neni 5**  
**Kapitali Themeltar**

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100,000 Lekë (nje qind mije leke).

Kapitali themeltar perbehet nga 1 (nje) kuote qe eshte paguar e zoterohet teresisht nga ortaku themelues si vijon:

Yllka Sula zotërues i 1 (një) kuote, me vlerë nominale 100,000 Lekë, duke përfaqësuar 100% (njeqind perqind) të kapitalit themeltar.

Ortaket jane pergjegjes kundrejt paleve te treta per humbjet qe peson Shoqeria, deri ne shumen e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.

Kapitali themeltar mund te zmadhohet ose te zvogelohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore.

Fitimi qe do te rezultoj nga veprimtari e shoqerise i takon ortakeve te saj. Shoqeria nuk pergjigjet per humbjen e ortakeve te saj jashte veprimtarise se shoqerise. Mosmarreveshjet qe mund te lindin mes paleve brenda dhe jashte shoqerise, me persona fizike e juridike zgjidhen nga Gjykatat kompetente Shqiptare.

**Neni 6**

**Kuotat**

**Te drejtat dhe detyrimet e lidhura**

Secili ortak do te kete nje numer proporcional votash me vleren nominale te kuotes se tij.

Pronesia mbi kuotat do te regjistrohet ne regjistrin e ortakeve qe do te mbahet ne seline e Shoqerise nen pergjegjesine e Administratoreve ("Regjistri i Ortakeve").

Regjistri i Ortakeve do te pasqyroje informacionin e meposhtem: (i) identitetin e cdo Ortaku; (ii) numrin dhe vlerën e kuotes qe zoterohet nga cdo Ortak; (iii) daten e fitimit te pronesise se secilit Ortak mbi kuotat; (iv) adresen apo seline e cdo Ortaku; (v) detaje per cdo peng apo barre te vendosur mbi kuotat.

**Neni 7**

**Transferimi i Kuotave**

1. Nese nje Ortak ka per qellim te transferoje ne cdo forme te gjithë apo nje pjese te kuotes se tij nje personi te ndryshem nga Ortaket, secili prej Ortakeve te tjere ka te drejten e parablerjes mbi te gjithë apo nje pjese te kuotes ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre ne kapitalin themeltar, ne varesi te faktit se sa ortake do te ushtrojne te drejten e parablerjes ne rastin konkret. E drejta e parablerjes ushtrohet vetem ne perputhje me proceduren ne vijim.
2. Nese nje Ortak ka per qellim te transferoje te gjithë apo nje pjese te kuotes se tij, ai, perpara se te nenshkruaje marreveshje me persona te ndryshem nga Ortaket, do te njoftoje me shkrim Administratoret per transferimin e planifikuar, duke percaktuar edhe çmimin e transferimit, personin/at te cileve planifikon t`u transferoje kuoten dhe kushtet esenciale qe do te aplikohen per transferimin.
3. Administratoret, brenda 10 diteve duke filluar nga dita kur eshte njoftuar nga Ortaku per shitjen apo transferimin e planifikuar, do te informojne me shkrim Ortaket e tjere.
4. Secili prej Ortakeve qe ka te drejta parablerjeje, brenda 1 (nje) muaji nga njoftimi prej Administratoreve per shitjen apo transferimin e planifikuar, do te njoftoje me shkrim Administratoret nese ka qellim te ushtroje te drejten e tij te parablerjes.
5. Administratoret brenda 10 diteve nga marrja e ketij njoftimi do te njoftojne me shkrim Ortakun qe deshiron te transferoje kuotat e tij.





V2022053240396743309

6. Nese me shume se nje Ortake ushtrojne te drejtat e parablerjes se kuotes, ata do te blejne kuoten ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre aktuale ne kapitalin themeltar.
7. Nese asnje njoftim nuk eshte dhene nga ndonje Ortak si me siper, Ortaku qe ka per qellim te transferoje kuoten e tij do te jete i lire t'ia transferoje kete kuote personit/ave te percaktuar prej tij.
8. Nese vetem nje Ortak ka dhene njoftim per qellimin e tij per te ushtruar te drejten e parablerjes, ky Ortak do te kete te drejte te bleje kuoten objekt transferimi brenda 10 diteve nga data e mbarimit te afatit 1 (nje) mujor te percaktuar me siper.
9. Çdo transferim i kuotave qe nuk kryhet ne perputhje me parashikimet e ketij neni eshte i pavlefshem dhe pa efekte per Shoqerine.
10. Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie apo brenda familjes

#### **Neni 8**

##### **Zmadhimi i Kapitalit**

Kapitali themeltar mund te zmadhohet, me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, nepermjet emetimit te kuotave te reja ose rritjes se vleres nominale te atyre ekzistuese ose ne çdo forme tjeter te parashikuar nga Ligji. Per cdo zmadhim kapitali te Shoqerise nepermjet emetimit te kuotave te reja, Ortaket do te kene te drejten e parablerjes per nenshkrimin e ketyre kuotave te reja te emetuara. Nese me shume se 1 (nje) Ortak ushtrojne te drejtat e tyre te parablerjes brenda 20 (njetzet) diteve, atehere ata do t'i blejne keto kuota ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre aktuale ne kapitalin themeltar. Çdo kuote e re qe nuk eshte blere nga Ortaket gjate ketij procesi, i ofrohet çdo pale te trete.

Kuotat e reja qe do te shlyhen si me para ne dore, ashtu edhe ne natyre, do te paguhen ne perputhje me Vendimin perkates per zmadhimin e kapitalit dhe Ligjin per Shoqerite Tregtare.

#### **Neni 9**

##### **Zvogelimi i Kapitalit**

Kapitali mund te zvogelohet, me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me Ligjin per Shoqerite Tregtare.

### **KAPITULLI III**

#### **ORGANET E SHOQERISE**

#### **Neni 10**

##### **Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve**

Asambleja e Pergjithshme do te jete organi me i larte i Shoqerise, i cili, veç kompetencave te tjera sipas Ligjit per Shoqerite Tregtare apo ketij Statuti, merr vendime per çeshtjet e meposhtme te Shoqerise:

- a. percaktimi i politikave tregtare;
- b. ndryshime te Statutit;
- c. emerimi i Administratoreve;
- d. emerimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe i eksperteve kontabel te autorizuar;
- e. miratimi i skemes se shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c. dhe d.;
- f. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve te ecurise se veprimtarise se Shoqerise;
- g. shperndarjen e fitimeve vjetore;
- i. zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themeltar te Shoqerise;
- j. pjesetimin dhe anulimin e kuotave;
- k. perfaqesimin e shoqerise ne gjykime;
- l. riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise;





m. miratimin e rregullave te zbatueshme procedurale te mbledhjeve te saj;

n. çeshtje te tjera sipas parashikimeve te bera prej ketij Statuti.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mblidhet ne rastet e percaktuara nga ligjet e aplikueshme ose nga ky Statut dhe sa here qe eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e Shoqerise. Asambleja e Pergjithshme mblidhet te pakten nje here ne vit.

Njoftimi per thirrjen e Asamblese se Pergjithshme mund te dergohet me shkrim apo e-mail ne adresat qe secili Ortak do t'i njoftoje me shkrim Shoqerise me poste te regjistruar. Njoftimi do te konsiderohet se i eshte dorezuar Shoqerise me kalimin e dites se 10-te pas dergimit.

Njoftimi per thirrjen e Asamblese duhet te percaktojte qarte emrin e Shoqerise, seline, daten, kohen dhe vendin e mbledhjes, nje pershkrim te hollesishem te procedures qe duhet te ndiqet nga Ortaket per pjesemarrjen dhe votimin, informacion mbi vendin e menyren e marrjes se dokumenteve dhe projekt-vendimeve qe duhet tu vihen ne dispozicion te gjithe Ortakeve, po ashtu edhe rendin e dites, dhe duhet t'u njoftohet Ortakeve te pakten 14 (katermbedhjete) dite para mbledhjes. Rendi i dites i njoftuar si me siper duhet te permbaje edhe vendimet e propozuara per çdo çeshtje. Nese Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve duhet te vendose per ndryshime te Statutit, teksti perkates duhet te njoftohet se bashku me rendin e dites.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve do te thirret nga Administratoret dhe, kur eshte e zbatueshme, nga Ortaket.

Nje Ortak mund te perfaqesohet ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete i ndryshem nga Administratoret, duke paraqitur dokumentin perkates autorizues. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si: përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë; emërimin e administratorëve; emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; përcaktimin e shpërblimeve; mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe nga Ligji Tregtar, vlefshmeria e vendimeve qe percaktojne detyrime shtese ose kufizojne / zvogelojne te drejtat qe u jane njohur ortakeve nga Ligji Tregtar apo nga ky Statut, kushtezohet nga miratimi i Ortakut te interesuar / perkates.

Te gjitha vendimet e Asamblese duhet te regjistrohen ne procesverbal. Administratoret jane pergjegjes per mbajtjen e nje kopjeje te tij.

**Neni 11**

**Organi Administrues / Administratoret**





Organi Administrues perbehet nga 1 (nje) Administrator qe emerohet e shkarkohet nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve. Kohezgjatja e mandatit te Administratorit eshte 5 (pese) vjet, me te drejte ri-emerimi.

Personi i mëposhtëm caktohen si Administrator i parë i shoqërisë me mandat 5 vjecar.

- **Yllka Sula, atësia Zenel, amësia Ferdane, shtetas Shqiptar, lindur në Tirane dhe banues në Tiranë, me adresë Bajram Curri; Nd. 0; H. 0; Ap. 0; Njësia Administrative Nr. 3; Njesia Bashkiake Nr. 4; 0000; Tiranë, lindur më 08/08/1974, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 034573969 dhe nr. personal H45808140E.**

Administratori perfaqeson Shoqerine sipas parashikimeve te Statutit.  
Administratori do te:

- (i) administroje veprimtarine tregtare te Shoqerise duke zbatuar politikat tregtare të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve;
- (ii) perfaqesoje Shoqerine;
- (iii) kujdeset per mbajtjen e rregullt te librave dhe dokumenteve kontabel;
- (iv) pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise, te cilat ia paraqet Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve per miratim, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve;
- (v) krijojte nje sistem njoftimi te pershtatshem per rrethanat qe kercenojne ekzistencen e Shoqerise;
- (vi) kryeje regjistrimet e publikimet e detyrueshme te te dhenave te Shoqerise, sipas kerkesave te Ligjit Tregtar apo te ligjeve te tjera te zbatueshme;
- (vii) raportoje perpara Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve mbi zbatimin e politikave tregtare si dhe per perfundimin e transaksioneve me rendesi te veçante per performancen e Shoqerise;
- (viii) kryeje detyra te tjera, te percaktuara ne Ligjin Tregtar dhe ne kete Statut;
- (ix) therrase mbledhjen e Asamblese se Ortakeve sa here qe kerkohej sipas Ligjit apo ketij Statuti.

Administratori mund te autorizojte persona te tjere per te vepruar ne emri dhe per llogarine e tij, duke specifikuar / percaktuar kategorine e akteve dhe veprimeve qe perfaqesuesi mund te kryeje. Veç kufizimeve ligjore, nuk vendosen kufizime te kompetencave te administrimit.

**Neni 12**

**Kontrolli i Shoqerise**

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te emeroje nje ose disa eksperte kontabel te autorizuar per kontrollin e llogarive te Shoqerise.

**KAPITULLI IV**

**VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, FITIMET DHE REZERVAT LIGJORE**

**Neni 13**

**Viti Financiar**

Viti financiar ka nje kohezgjatje prej 12 (dymbedhjete) muajsh e cila fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti.  
Ne menyre perjashtimore, viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar.

**Neni 14**

**Rezerva Ligjore**

Shoqeria do te kaloje ne fondin rezerve te detyrueshem te pakten 5% (pese perqind) te fitimit vjetor neto derisa kjo rezerve te arrije vleren e barabarte me 10% (dhjete per qind) te kapitalit themeltar.





12022033240396743309

#### **Neni 15**

##### **Dividendet**

Pas miratimi te bilancit vjetor dhe percaktimit te shumes qe do te ndahet, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve percakton shumen e fitimeve qe do t'i shperndahet secilit prej Ortakeve si dividend, ne perpjestim me pjesen perkatese ne kapitalin themeltar.

Fitimi i deklaruar ne pasqyrat financiare mund te shperndahet vetem nese shoqeria ka likuiditet te mjaftueshem qe garanton shlyerjen e detyrimeve.

#### **KAPITULLI V**

#### **PRISHJA - LIKUIDIMI**

#### **Neni 16**

##### **Prishja e Shoqerise**

Shoqeria priset (i) me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve; ose (ii) ne rast falimentimi; ose (iii) kur Shoqeria nuk ka kryer veprimtari per 2 (dy) vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne QKB; ose (iv) me vendim gjykate; ose (v) per arsye te tjera te parashikuara ne ligj.

#### **Neni 17**

##### **Likuidimi**

Me perjashtim te rastit te fillimit te nje procedure falimentimi, prishja e Shoqerise shoqerohet me fillimin e procedures se likuidimit.

#### **Neni 18**

##### **Dispozita Perfundimtare**

Per te gjitha ceshtjet qe nuk jane parashikuar ne kete Statut, do te zbatohen parashikimet e Ligjit Tregtar.

Konfliktet ne lidhje me kete Statut do te zgjidhen nga gjykata e rrethit gjyqesor ne territorin e se ciles Shoqeria ka seline e saj.

Me qellim shmangien e cdo paqartesisie, ndryshimi i ortakeve dhe/ose Administratorit, dhe/ose cdo funksionari tjetër nuk do te konsiderohen si ndryshime te ketij Statuti.

Ky Statut nenshkruhet rregullisht ne 3 (tre) origjinale ne gjuhen Shqipe.

#### **ORTAKU THEMELEUES**